




REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. 2D/DPK
 Nr. i faq. 02
 Nr. pages
 Nr. Prot. 01-3884/13
 Prot. No.
 Data 15.11.2013
 Date
 PRISTINE



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATE/A:	15/11/2013
REFERENC-Ë:	AKK-DPK
PËR/ZA/TO:	z. Abdulsatar IBRAHIMI Drejtor i Departamentit të Prokurimit në KOSTT sh.a
CC:	z. Naim BEJTULLAHU Kryeshef Ekzekutiv në KOSTT sh.a
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin " Furnizimi dhe Instalimi i TR3.40 MVA në NS 110/10 KV- Prishtina 2 "

Të nderuar,

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit për Agjencinë kundër nr.03/L- 159 dhe nenin 19 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me tenderin " Furnizimi dhe Instalimi i TR3.40MVA në NS 110/10 KV- Prishtina 2 " me nr. të prokurimit: KOSTT 13 79 511, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Kërkohet nga ju si autoritet kontraktues (në tekstin e mëtejme A.K), që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin " Furnizimi dhe Instalimi i TR3.40MVA në NS 110/10 KV- Prishtina 2 " në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr.04 – L/042 për Prokurimin Publik.

Arsyetim

Departamenti i Prokurimit pranë KOSTT-it ka përgatitë “ Njoftimin për Kontratë ” me titull “ Furnizimi dhe Instalimi i TR3,40MVA në NS 110/10 KV- Prishtina 2 “ me nr. prokurimi: KOSTT 13 79 511, e cila është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me dt. 06.11.2013, në Procedurë të Hapur. Divizioni i Parandalimit të Korrupsionit në Prokurimin Publik pranë Departamentit të Parandalimit në Agjencinë Kundër Korrupsionit ka identifikuar këtë procedurë prokurimi si rast për trajtim. Gjatë ekzaminimit të kësaj procedure të prokurimit në “ Njoftimin për Kontratë ” Agjencia Kundër Korrupsionit ka hasur në disa të dhëna që nuk janë në përputhje të plotë me Procedurat e Prokurimit të cilat rregullohen me ligjin e Prokurimit Publik i cili është i zbatueshëm në Republikën e Kosovës.

Në “ Njoftimin për Kontratë ” të publikuar në faqen elektronike të KRPP-së, më datë 06.11.2013, tek pika III.2.3 e rubrikës Kapaciteti ekonomik dhe financiar tek pika 1 është kërkuar Qarkullim Financiar nga viti 2010 së paku 10,000,000.00 € (i dokumentuar me kopje të kontratave dhe vlera të Kontratave) , pikë e cila bie ndesh me ligjin në fuqi për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.

Po ashtu tek pika e njëjtë e rubrikës Kapaciteti ekonomik dhe financiar , është kërkuar që nëse Operatori Ekonomik është në Konzorcium, atëherë Kryesuesi i Konzorciumit duhet të ketë qarkullim vjetor së paku 70 % e vlerës së shënuar nën pikën a.

Në “ Dosjen e Tenderit ” që ka përgatitur A.K , tek pika III.2.3 e rubrikës “ Kapaciteti ekonomik dhe financiar “ pika 1 , gjithashtu kërkohet Qarkullimi Financiar nga viti 2010 së paku 10,000,000.00 € (i dokumentuar me kopje të kontratave dhe vlera të kontratave) si dhe për ata OE që janë në konzorcium është kërkuar që kryesuesi i konzorciumit të ketë qarkullim vjetor së paku 70% e vlerës së shënuar nën pikën a.

Kriteret e lartcekura në pikën III.2.3 të rubrikës Kapaciteti Ekonomik dhe Financiar pika 1 siq janë përshkruar në “ Njoftimin për Kontratë ” dhe “ Dosjen e Tenderit “ janë kritere diskriminuese dhe në këtë mënyrë eliminojnë konkurrencën e lirë dhe favorizojnë Operatorët Ekonomik të caktuar.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin 68 Gjendja Ekonomike dhe Financiare dhe nenin 71 Grupet e Operatorëve Ekonomik dhe Operatorët e Huaj Ekonomik të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj AKK rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe të shmangen praktika të tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt!